



# Sjellja elektorale në Bashkinë e Durrësit, Shqipëri, 2015

(Resource ID: 287)

**Dorina Berdufi**

berdufidorina(at)gmail.com

This teaching resource is allocated to following University:

**UAMD - Aleksandër Moisiu University of Durrës**

<http://www.sustainicum.at/sq/modules/view/287.Sjellja-elektorale-n-Bashkin-e-Durrsit-Shqipri-2015>



**Puna në grup**



**Me pak sesa 5  
studente**



**Deri në 3 njësi  
leksionesh**



**Lidhja me Web  
e nevojshme**



**Anglisht, Shqip**

Sjellja elektorale është një formë demokratike e qëndrimit politik. Të kuptosh sjelljen e votuesit ndihmon në shpjegimin e "si" dhe "pse" merren vendimet nga secila palë e përfshirë në këtë marrëdhënie: si nga ana e vendimmarrësve/institucioneve apo vetë elektorati. Studimet mbi këtë çështje mundësojnë dhënien e përgjigjeve të duhura problemeve konkrete. Në këtë aspekt, ky projekt i fokusuar në elektoratin e Bashkisë së Durrësit në vitin 2015 (vit zgjedhor lokal). Studentët do të përpiqen të skicojnë një strukturë të përbërësve të sjelljes së votuese. Rezultati do të shërbejë në përmirësimin e mirëqënies dhe prosperitetit të bashkisë. Ata do të mbledhin dhe analizojnë të dhëna mbi këtë çështje. Për më tepër që nëpërmjet këtij projekti të tipit të "mësuarit pro-aktiv", ata do të kenë mundësinë të jenë pjesë e një procesi konsultimi me vendim-marrësit lokal.

*Sjellja votuese elektorale* është një komponent me shumë rëndësi në jetën ekonomike-politike-sociale të Republikës së Shqipërisë. Në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë është formuluar në nenin 1, pika 3: "Qeverisja bazohet në zgjedhje të lira, të barabarta, të përgjithshme dhe periodike". Kështu që vota shpreh mekanizimin e drejtpërdrejtë me anën e të cilit individi merr pjesë në procesin politik, me përfaqësueshmëri. Përbën një nga drejtimet e fokusit të aktorëve politik ku ata ofrojnë programe, platforma politike, etj. Baza e zhvillimit të politikave të qëndrueshme ndërtohet mbi interesin e votuesit.

Studentët do të tentojnë tu japin përgjigje gjatë *kërkimit* këtyre pyetjeve të procesit elektoral: Si voton elektorati? Si dhe pse ai e merr vendimin e tij? Mbi bazë të cilave kritere? Cilat janë implikimet që rrjedhin prej këtij vendimi dhe sjellje? Arsyen e përzgjedhjes së një partie mbi një tjetër? Cila është lidhja midis votuesit dhe vendim-marrësit? Si mund të bëhet ky *bashkëpunim* më *efektiv* dhe *eficient* në drejtim të zhvillimit *social-ekonomik-politik* në *qytetin e Durrësit*?

Për më tepër, në kontributin drejt zhvillimit të demokracisë dhe mirëqënies së njësisë lokale është me rëndësi themelore analizimi i "kriterit përzgjedhës" me të cilin votuesit bëjnë zgjedhjen e tyre politike. Ky kriter ndryshon nga votuesi në votues. Ato mund të grupohen në: racional, ideologjik, abstenues, etj., në varësi të faktorëve të cilët kanë ndikuar në strukturimin e sjelljes së tyre. Studentët do të përpiqen të ndërtojnë një strukturë të këtyre tipeve dhe elementeve të tyre përbërës në Bashkinë e Durrësit.

Qëllimi është tu sigurojë atyre *njohuri praktike* në identifikimin e sjelljes votuese të Bashkisë së Durrësit. Njëkohësisht do tu sigurojë mundësi *konsultimi proaktiv* me qeverisjen lokale. Njohuritë bazike të nevojshme janë tekste dhe *program përpunimi të të dhënave* në shkencat sociale. Kjo eksperiencë do tu mundësojë atyre njohuritë e nevojshme në analizimin kritik. Ata gjithashtu do të ndërmarrin një *kërkim bazik empirik* në terren dhe do të mund të japin në fund të kërkimit rekomandimet e përshtatshme aktorëve të interesuar politik. Do të mësojnë të përzgjedhin *teknikat* dhe mjetet e kërkimit në bazë të natyrës së problemit, duke iu përshtatur kostove dhe vështirësive të tij. Në përfundim të projektit, studentët do të kuptojnë se si studiuesit i zhvillojnë kërkimet e tyre. Si ata arrijnë në përfundime në lidhje me problemet konkrete të jetës.

Në anën tjetër, palët e interesuara, nëpërmjet *konsultimeve* për sjelljen votuese, do të përfitojnë një këndvështrim akademik të këtij problemi. Ky *bashkëpunim* do të shërbejë në ndërtimin e politikave më të përshtatshme

lokale ndaj interesave të zgjedhësve. Kështu që, të gjitha palët e përfshira në këtë projekt njëkohësisht me përfitimin, do të mund të japin kontributin e tyre në drejtim të *zhvillimit të qendrueshëm social*.

---

## Mjetet e mësimdhënies



Field study Case study Program kompjuteri

## Integrimi i palëve të interesuara shoqërore

Partitë politike dhe qeverisja lokale përfitojnë nga bashkëpunimi me studentët duke qenë se ata do të marrin një perspektivë ndryshe dhe këndvështrim të ri në lidhje me aktivitetet dhe politikat e tyre për votuesit. Ata gjithashtu përfitojnë një zgjidhje të mundshme shkencore të këtij problemi.

### Pika e forte

- Eksperiencë për studentët të të mësuarit në mënyrë aktive
- Palët e interesuara përfitojnë nëpërmjet network-ut që do të ndërtohet
- Studentët do të mendojnë rreth mundësive dhe përgjegjësive të tyre në kontekstin e ndryshimeve botërore.

### Pika e dobët

- Probleme të mundshme me konfidencialitetin
- Shembull: Aktorët politikë duhet të bien dakord për të diskutuar problemet e tyre me studentët. Në këtë mënyrë do të jetë më e lehtë që të përfshihen student të cilët kanë qenë pjesë e kërkimeve në terren më parë.

## Rezultatet e të mësuarit

- Ndërmarrja e një kërkimi bazik
- Aplikimi i analizave bazike statistikore
- Dhënia palëve të interesuara zgjidhje të përshtatshme të problemit

## Lidhja për qëndrueshmëri

- Manaxhim i qëndrueshëm i skenarit të problemit nëpërmjet kërkimeve praktike të problemeve reale
- Ndërmarrësi e qëndrueshme të kërkimit në terren
- Kontribut i qëndrueshëm në zhvillimin e demokracisë dhe mirëqënies së njësisë lokale
- Bashkëpunimi i qëndrueshëm në drejtim të efikasitetit dhe efektivitetit të zhvillimit social-ekonomik
- Kontribut në manaxhimin e qëndrueshëm nga niveli mikro (lokal) në atë makro (kombëtar) të zhvillimit demokratik

## Njohuri paraprake

Asnje lloj njohurie paraprake specifike nuk kërkohet?

## Përpjekjet e përgatitjes

Mesatare

## Përshkrimi i përpjekjeve të përgatitjes

- Përgatitja e leksioneve (3 ditë): - Identifikimi i problemit të përshtatshëm ndaj palëve të përfshira në drejtim të sjelljes elektorale. Ata duhet të sigurojnë të dhëna të mjaftueshme dhe të jenë të hapur ndaj bashkëpunimit me studentët. - Takimet duhet të skedulohen për a) diskutime b) intervista c) anketim dhe d) prezantim të rezultateve dhe rekomandimeve. Skedulimi i kohës rreth 16 orë në total (përgatitje, prezantim, kërkim në terren, analizë të dhënash, rezultate, rekomandime)

## Aksesi

Free

## Gjykimi / vlerësimi

Studentët do të vlerëhen me maksimumi 100 pikë në bazë të punës në grup.

## Kreditim/Çertifikatë

Vlerësim me 100 pikë

## Financuar nga

This teaching resource, realised within the project ConSus, has been funded with the support of the TEMPUS of the European Union. The contents reflect the views of the authors, and the European Commission cannot be held responsible for any use which may be made of the information contained therein.